



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUFSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) bazuar në nenin 108 pika të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Rregullores nr.9/2016 për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës (të ndryshuar me Rregulloren 14/2016), shpall

KONKURS

PËR GJYQTAR MBIKËQYRËS PËR DEGEN ZUBIN POTOK

KRITERET DHE KUALIFIKIMET PËR KANDIDATË

- Të drejtë aplikimi për gjyqtarë mbikëqyrës të degës kanë të gjithë gjyqtarët e asaj dege.
- Kandidati për gjyqtar mbikëqyrës të degës duhet të ketë tri (3) vite përvojë pune si gjyqtar.
- Kandidati për kryetar të gjykatës të mos ketë sanksion disiplinor me vendim të formës së prerë, përjashtimisht nëse ndaj tij është shqiptuar masa e qortimit vetëm një herë.
- Kandidati për kryetar të gjykatës duhet të
 - o njoh punën e administratës gjyqësore;
 - o ketë reputacionin të cilin kandidati gëzon nga ana e kolegëve gjyqtarë;
 - o ketë komunikimin korrekt me palë dhe kolegë brenda gjykatës;
 - o jetë i gatshëm për bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera;
 - o të jetë kreativ në punë, duke lehtësuar kështu punën e gjykatës.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të merr në konsideratë trajnimet apo përvojën menaxherie të kandidatit për gjyqtar mbikëqyrës të gjykatës.

FORMULARI I APLIKACIONIT

Kandidatët për gjyqtarë mbikëqyrës Zubin Potok aplikacionin mund ta shkarkojnë në Ueb faqen e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org)

[Shkarko Aplikacionin](#)

KONCEPT DOKUMENTI

Bashkë me aplikacionin për kryetarë të gjykatës kandidatët paraqesin:

- Koncept dokumentin lidhur me vizionin e kandidatit për mënyrën e menaxhimit të gjykatës si dhe ngritje së efikasitetit në bazë të resurseve ekzistuese:
 - i. Për implementimin e rregulloreve, vendimeve, strategjive dhe planeve të veprimit, të aprovuara nga ana e KGJK-së;
 - ii. Për menaxhimin e gjykatës dhe degëve të saj;
 - iii. Planin për administrimin efikas dhe efektiv të drejtësisë në gjykatë dhe degët e saj;
 - iv. Për veprimtarinë financiare, buxhetore dhe prokurimin;
 - v. Për personelin e gjykatës;
 - vi. Për identifikimin dhe adresimin e problemeve si dhe propozimin për zgjidhjen e tyre.

Aplikacionin bashkë me dokumentet e tjera të kërkuara dorëzohen në Sekretarin e KGJK-së, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes së pozitës së lirë.

PËR MË SHUMË INFORMACIONE, JU LUTEM REFEROJUNI RREGULLORES 09/2016 PËR PROCEDURAT E ZGJEDHJES, EMËRIMIT, VLERËSIMIT, PEZULLIMIT DHE SHKARKIMIT TË KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS. (TË NDRYSHUAR ME RREGULLORET 14/2016 DHE 17/2016).